



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:164703
Datë: 13.02.2024
Numri i dokumentit: 05318230

Rev.nr.542/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Milena Gjeriq dhe Nenad Lazic, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Korab Blakçori nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kadri Begolli, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Artina Morina Elshani nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Korab Bokshi, avokat në Gjakovë, me objekt kontesti, ndryshim i aktgjykimit lidhur me besimin e fëmiut dhe caktim kontakti, duke vendosur sipas revizionit të autorizuarit të paditësit, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3714/23 të datës 28.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 12.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pathemeltë revizioni i të autorizuarit të paditësit Korab Blakçori nga Prishtina, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3714/23, datë 28.08.2023 në lidhje me pikën II, III dhe IV të dispozitivit, ndërsa pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi ndryshohet dhe kontakti i babait-paditësit me fëmijën realizohet ashtu siç është përcaktuar me aktgjykimin C.nr.2076/16, i datës 13.10.2017.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Gjakovës, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1028/21 të datës 28.03.2023, në pikën I të dispozitivit është aprovuar në tërësi kërkesëpadia e paditësit Korab Blakçori nga Prishtina, kundër të paditurës Artina Morina Elshani nga Gjakova. Në pikën

